



## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarve B. M. dhe T. M. nga P., për shkak të veprës penale vrasje në tentativë në bashkëkryerje nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të dënuarve B. S. nga f.sh. Sh., Komuna e I., E. A. dhe A. U. të dy nga P., për shkak të veprës penale pjesëmarrja në rrahje në bashkëkryerje nga neni 187 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, duke vendosur sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të dënuarve B. M., T. M. dhe E. A. të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.44/2022 të datës 30.08.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.631/2023, të datës 22.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 22.05.2024, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të dënuarve B. M., T. M. dhe E. A., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.44/2022 të datës 30.08.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.631/2023, të datës 22.12.2023.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.44/2022 të datës 30.08.2023, të dënuarit B. M. dhe T. M. janë shpallur fajtor për veprën penale vrasje në tentativë në bashkëkryerje nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK, ndërsa të dënuarit B. S., E. A. dhe A. U., për veprën penale pjesëmarrja në rrahje në bashkëkryerje nga neni 187 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, dhe janë gjykuar: I dënuari B. M. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, i dënuari T. M. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite, i dënuari B. S. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muajve, i dënuari E. A. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, dhe i dënuari A.U. me dënim burgimi në kohëzgjatje

prej 6 (gjashtë) muaj, dënime këto në të cilat është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe atë të dënuarit B. M. prej datës 01.11.2021 e gjer në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, të dënuarit T. M. nga data 06.11.2021 e gjer më datën 30.06.2021, të dënuarve E. A. dhe A. U. prej datës 17.08.2021 e gjer më datën 12.10.2021, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dënuarit janë detyruar që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës si dhe në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej nga 100 (njëqind) Euro, si dhe të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) Euro, secili veç e veç në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.631/2023, të datës 24.11.2023, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë dhe ankesat e mbrojtësve të të dënuarve, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë paraqitur:

-Mbrojtësi i të dënuarit B. M. avokati Gëzim Kollçaku, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozimin që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ose aktgjykimet të ndryshohen duke e bërë rikualifikimin e veprës penale nga vepra penale vrasje në tentativë në bashkëkryerje në veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 të KPRK.

-Mbrojtësi i të dënuarit T. M. avokati Shkodran Manaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozimin që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ose aktgjykimet të ndryshohen duke e bërë rikualifikimin e veprës penale nga vepra penale vrasje në tentativë në veprën penale pjesëmarrje në rrahje nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK.

-Mbrojtësi i të dënuarit E. A. avokati Fatmir Kurmehaj, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozimin që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ose të ndryshohen dhe të dënuarit ti shqiptohet një dënim me kusht ose me gjobë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.117/2024, e datës 05.04.2024, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve B. M., T. M. dhe E. A., të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pasi i vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesat janë të pabazuara.

Mbrojtësi i të dënuarit B. M., në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se gjykata e shkallës së parë e ka bazuar aktgjykimin vetëm në deklaratën e të dëmtuarit D. E. si dhe pretendimeve të pabazuara të Prokurorisë të theksuara në aktakuzë duke mos dhënë arsytim pse ja ka falur besimin deklaratës së dëmtuarit apo edhe pretendimeve të Prokurorisë. Më tutje në kërkesë mbrojtësi e ka bërë elaborimin e deklaratave të dëmtuarit D. E. të dhëna gjatë fazave të procedurës. Pretendohet më tutje në kërkesë se nëse gjykata e shkallës së parë ka konsideruar se ka ekzistuar dashja e të dënuarit B. M. për ta privuar nga jeta të dëmtuarin është dashur që të jep arsytim për dashjen, sepse vet i dëmtuari në çdo fazë ka deklaruar se B. e ka goditur me dorëz të armës, atëherë lind pyetja se pse i dënuari nuk ka shtënë me armë në trupin e të dëmtuarit D. E..

Theksohet më tutje në kërkesë, pra edhe pse gjykata e shkallës së parë ka pasur mëdyshje për çështjen kryesore se a ekzistojnë dashja e të dënuarit apo jo për ta privuar nga jeta të dëmtuarin D., gjykata duke bërë shkelje të dispozitave ligjore, ka vendosur në dëm të dënuarit B. M.. Theksohet se me këto veprime janë shkelur rregullat bazike të prezumimit të pafajësisë, parimi in dubio pro reo. Gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë, se cilat fakte dhe çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara kur ka marr aktgjykim dënues. Po ashtu edhe gjykata e Apelit e Kosovës, nuk i ka analizuar fare këto shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe ka marr aktgjykim me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën tonë. Konstatimet nga gjykata e shkallës së dytë në tërësi janë në kundërshtim me vetë dispozitivin e aktakuzës si dhe me provat materiale të administruara gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor.

Në kërkesën e mbrojtësit të dënuarit T. M., pretendohet se gjykata e shkallës së dytë i ka anashkaluar pretendimet ankimore të mbrojtjes dhe e njëjta nuk ka dhënë arsytim se pse pretendimet ankimore të mbrojtjes janë të pabazuara, andaj, mbrojtja konsideron se arsytimi i gjykatës së shkallës së dytë është i pa mjaftuar dhe një arsytim i pa mjaftuar, konsiderohet arsytim i munguar. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsytim në pretendimin e mbrojtjes se në këtë çështje penale nuk ekziston bashkëkryerja në veprimet e të dënuarit T. M. në kryerjen e veprës penale.

Pretendohet se aktgjykimet janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 lidhur me nenin 369 paragrafi 6 dhe 7 e cila shkelje ka ndikuar në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë ngase në aktgjykimet e tyre nuk i kanë paraqitur arsytet për çdo pikë të aktgjykimit si dhe nuk i kanë paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh konsiderojnë të vërtetuara apo të pavërtetuara. Po ashtu në kërkesë theksohet se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për faktin se me këto aktgjykime nuk ka mundur të vërtetohet qëllimi dhe dashja e të dënuarit për privimin e të dëmtuarit nga jeta.

Më tutje pretendohet se dy aktgjykimet janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7 lidhur me nenin 369 paragrafi 8 të KPP-së, ngase në këtë pikë aktgjykimi nuk kanë arsytim të mjaftuar, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka konstatuar se ndaj të dënuarve B. dhe T. nuk ka gjetur rrethana lehtësuese. Theksohet në kërkesë se si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe shkeljes së parimeve të procedurës penale, ndaj të dënuarit taulant është shkelur edhe ligji penal në dëm të tij nga neni 385 të KPP-së.

Në kërkesën e mbrojtësit të dënuarit E. A., theksohet se dënimi i shqiptuar nuk është në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale të dënuarit në momentin e kryerjes së veprës penale. I dënuari për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, ka pranuar fajësinë në seancën e shqyrtimit fillestar, ka pasur sjellje korrekte ndaj gjykatës, i njëjti është penduar thellë për veprën e kryer, ka premtuar para gjykatës se nuk do të kryej vepra penale, i ka kërkuar publikisht falje palës së dëmtuar dhe dënimi i shqiptuar është shumë i lartë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikojë shkresat e lëndës dhe analizojë pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve B. M., T. M. dhe E. A., konstatojë se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal, siç pretendohet në kërkesa.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se si aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë janë përpiluar në formën e parashikuar me ligj, pasi që përmbajnë të gjitha elementet që kërkohen sipas dispozitave përkatëse ligjore, si në pjesën e dispozitivit, ashtu edhe në pjesën e arsytimit.

Duke ju referuar pretendimeve të mbrojtjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se dispozitivi i këtyre aktgjykimeve është i qartë, nuk është në kundërshtim me vetveten dhe është në harmoni me arsytimin e tyre.

Gjithashtu, duke ju referuar pretendimeve nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është përshkruar në mënyrë të hollësishme vepra penale për të cilën janë shpallur fajtor të dënuarit B. M., T. M. së bashku me faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal.

Nga kjo pjesë e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton se janë paraqitur këto elemente të figurës së veprës penale dhe atë: koha dhe vendi i kryerjes së veprës penale, se vepra penale ishte kryer në atë mënyrë që për shkak të një problemi që kishte pasur B. me viktimën pak ditë më parë, ashtu që i fton dhe takohen me të pandehurit B. S., A. U., E. A., të cilët pasi që vijën në lagjen ku e kishte viktimën shtëpinë, me të parë viktimën i cili ishte duke shkuar në këmbë tek një fq i tij, të dënuarit B. e T. të pajisur me sende të rrezikshme në duar e sulmojnë të njëjtin konkretisht i dënuari T. duke e goditur me çekan në krahëror dhe kokë gjersa i dënuari B. nga prapa e godet disa

herë me mjet të fortë në kokë nën kërcënimin e armës, viktimës i shkaktojnë lëndime të rënda trupore në pjesën vitale të trupit.

Në këtë mënyrë, rezulton se në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, tek pjesa e përshkrimit të veprimeve kryerëse të dënuarve janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme të gjitha rrethanat dhe faktet të cilat i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të figurës së veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor të dënuarit B. M. dhe T. M..

Po ashtu, edhe në arsyetimin e këtij aktgjykimi shihet qartë që janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha pikat e aktgjykimit, përshkrimet e dhëna në arsyetim përmbajnë të gjitha arsyet për faktet relevante të cilat janë paraqitur qartë dhe në asnjë mënyrë nuk paraqiten si kundërthënëse, ndërsa pjesa e arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë përfshirë arsyet në lidhje me vlerësimin e pretendimeve ankimore, si dhe shkeljet, për të cilat gjykata në fjalë është kujdesur sipas detyrës zyrtare.

Nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe nga shkresat tjera të lëndës rezulton se në këtë rast janë vlerësuar dhe analizuar në mënyrën e duhur të gjitha provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ashtu siç është parashikuar në nenin 360, paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale, ku pastaj pas një procesi të tillë, mandej janë nxjerrë konkluzionet e caktuara, që kanë të bëjnë si me gjendjen faktike, ashtu edhe aspekte tjera juridike.

Përveç që aktgjykimet nuk janë të përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, me aktgjykimet e lartcekura nuk është shkelur as ligji penal në dëm të dënuarve B. M. e T. M., pasi që veprimet e të njëjtëve i përmbajnë të gjitha elementet e figurës së veprës penale vrasja në tentativë në bashkëkryerje, nga neni 172, lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, për të cilën të dënuarit janë shpall fajtor.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës pretendimi i mbrojtësit të dënuarit T. M. se ky i dënuar veprën penale nuk e ka kryer në bashkëkryerje me të dënuarin B. M. është i pabazuar. Kjo Gjykatë vlerëson se ky i dënuar veprën penale për të cilën është shpall fajtor e ka kryer në bashkëkryerje me të dënuarin B. M.. Instituti i bashkëkryerjes sipas nenit 31 të KPRK, përkufizohet nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.

Nga kjo rezulton se bashkëkryerja shprehet në dy situata: a) situata e parë e cila është edhe më e shpeshtë, është rasti kur dy apo më shumë persona së bashku ndërmarrin veprimin e kryerjes së veprës penale, p.sh dy persona e godasin me gjësende të forta personin e tretë dhe me këtë kryejnë vrasjen. b) situata e dytë shprehet në rastet kur krahas personit i cili ndërmerr veprimin e kryerjes, peroni tjetër në masë të konsiderueshme, apo thelbësisht siç shprehet ligji, kontribuon në kryerjen e veprës penale. Nga ky përkufizim i bashkëkryerjes, kuptohet se në këtë çështje penale si në rastin konkret i dënuari T. M. veprën penale e ka kryer në bashkëkryerje me të dënuarin

e parë B. M., ashtu siç drejtë kanë gjetur dhe konstatuar edhe gjykatat e instancave më të ulëta për faktin se me gjitha provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor drejtë është vërtetuar se edhe i dënuari T. M. ditën kritike së bashku me të dënuarin B. M. i kanë ndërmarr veprimet e kryerjes së veprës penale duke e goditur të dëmtuarin D. E. me mjete të forta në pjesët vitale të trupit dhe i kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore, prandaj pretendimi se nuk bëhet fjalë për bashkëkryerje është i pabazuar.

Pretendimet e mbrojtësve të dënuarve B. e T. M., se në veprimet e të dënuarve nuk qëndrojnë elementet e veprës penale vrasje në tentativë por mund të bëhet fjalë por një rikualifikim tjetër të veprës penale lëndim i lehtë trupor apo veprës penale pjesëmarrje në rrahje, kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara. Me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, si me provat personale dhe materiale u vërtetua se me mjetet e përdorura dhe goditjet me këto mjete kundër të dëmtuarit disa herë në kokë nga ana e të dënuarve B. dhe T. M. dhe lënien e të dëmtuarit pa vetëdije e të shtrirë në tokë e në anën tjetër vet deklarimi i të dënuarit B. se kam muajt edhe me e mbyjt qysh kam qenë i fryr në të dëmtuarin e vërteton të kundërtën e pretendimeve të mbrojtjes, e rëndësishme është që plagët janë shkaktuar nga dy të dënuarit dhe atë në pjesën vitale të trupit të dëmtuarit, e që sipas ekspertizës mjeko-ligjore janë lëndime të rënda trupore, prandaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se bëhet fjalë për vepër penale të vrasjes në tentativë në bashkëkryerje nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK e jo vepër tjetër penale siç pretendojnë mbrojtësit e të dënuarve.

Pretendimet e mbrojtësit B. M. se provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe të njëanshme, ngase aktgjykimi i kundërshtuar bazohet vetëm në deklaratën e të dëmtuarit, nuk qëndrojnë ngase në këtë çështje penalo juridike gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë e ka vërtetuar se ditën kritike i dëmtuari D. E., si pasojë e konfliktit fizik me të dënuarit B. M. dhe T. M. ka pësuar lëndime të rënda trupore të përshkruara më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit, e që lëndimet në fjalë janë vërtetuar, përveç me dokumentacionin mjekësor të lëshuar nga Qendra Spitalore në P. edhe nga ekspertiza mjeko ligjore, nga e cila, pastaj është vërtetuar edhe mjeti me të cilin janë shkaktuar lëndimet trupore, që janë shkaktuar me mjet të fort mbretës, por jo prehës, e që faktet dhe rrethanat në fjalë janë vërtetuar pastaj edhe nga deklaratat e të dëmtuarit D. E., dëshmitarit D. A. si dhe vet të akuzuarve E. A. dhe A. U., e pjesërisht edhe nga deklaratat e të dënuarve B. e T. M..

Prandaj duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura si dhe rrethanat dhe arsyet më detajisht të theksuara në aktgjykimet e kundërshtuara, rezulton se konkludimi i gjykatave të instancës më të ulët, se të dënuarit B. M. dhe T. M., janë kryes të veprës penale vrasje në tentativë në bashkëkryerje nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK, ndërsa të dënuarit B. S., E. A. dhe A. U., të veprës penale pjesëmarrja në rrahje në bashkëkryerje nga neni 187 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK.

Përndryshe, duhet theksuar se kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë përmbajë edhe pretendime të caktuara që ndërlidhen me gjendjen faktike, mirëpo, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se konform nenit 432, paragrafi 2 të KPP-së, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë

të gjendjes faktike, andaj edhe rrjedhimisht pretendimet e tilla të mbrojtësve të dënuarve nuk janë shqyrtuar fare.

Pretendimi i mbrojtësit të dënuarit E. A., se gjykata nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit të dënuarit është i pabazuar. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate të dy gjykatat e instancave më të ulëta drejtë i kanë vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të dënuarit, për këtë dy gjykatat kanë paraqitur arsyetim të mjaftuar dhe të plotë në aktgjykimet e tyre e me të cilat arsyetime pajtohet edhe kjo gjykatë pa dashur që edhe njëherë të bëjë elaborimin e tyre.

Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385, paragrafi 5. të KPP, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet vetëm në rastet kur gjykata i ka tejkuluar kompetencat ligjore me rastin e shqiptimit të dënimit, ndërsa në rastin konkret nuk ka ndodhur një gjë e tillë.

Në rast se nuk është fjala për këtë shkelje, vendimi për dënimin me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik, mund të kundërshtohet vetëm nëse kjo pjesë e aktgjykimit është marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila do të mund të ndërli dhej me mungesën ose paqartësitë e arsyeve lidhur me vendimin për dënimin, mirëpo, në rastin konkret një pretendim i këtillë në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është paraqitur.

Nga arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.206/2024, më datë 22.05.2024

Procesmbajtës,  
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,  
Mejreme Memaj